



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Politikën e Jashtme*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 7.12.2022, ora 14:00

#### **Drejtton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit për datat 6-24 dhjetor 2021.
2. Diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër të huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, për mbështetjen e përpjekjeve të Republikës së Shqipërisë për zbutjen e pandemisë COVID-19”. (*Komision për dhënie mendimi*)

#### **Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Greta Bardeli, Besion Ajazi, Vangjel Dule, Bardhyl Kollçaku, Kreshnik Çollaku, Hatixhe Konomi, Klodiana Spahiu, Lavdim Krashi, Shpëtim Idrizi, Alqi Bllako dhe Benet Beci.

#### **Mungojnë:**

Grida Duma, Belind Këlliçi, Tritan Shehu, Tomor Alizoti dhe Blendi Klosi.

#### **Të ftuar:**

Adela Xhemali - Zëvendësministre e Ministrisë për Financat dhe Ekonominë  
Elona Mistrovica - Drejtore në Drejtorinë e Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndihmës së Huaj

Endrit Lami - Drejtor në Drejtorinë e Analizave Makroekonomike dhe Statistikave

Xhoana Agolli - Drejtore në Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit

## HAPET MBLEDHJA

**Mimi Kodheli** – Mirëdita të gjithëve!

Po zhvillojmë sot mbledhjen e datës 7.12.2021 të Komisionit për Politikën e Jashtme.

Në rendin e ditës kemi miratimin e kalendarit të punës së komisionit për datat 6-24 dhjetor 2021, si dhe diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër të huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, për mbështetjen e përpjekjeve të Republikës së Shqipërisë për zbutjen e pandemisë Covid-19”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Bllako.

Të ftuar për pikën e dytë janë zëvendësministrja Xhemali, zonja Mistrovica, zoti Lami dhe zonja Agolli.

Nëse nuk ka ndonjë gjë për të shtuar për kalendarin e punës së komisionit për datat 6-24 dhjetor, e konsideroj të miratuar.

Kalojmë në diskutimin e projektligjit.

Zonja Xhemali, fjala është për ju. Ju lutem, thoni dy fjalë për projektligjin!

**Adela Xhemali** – Faleminderit, zonja kryetare!

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, për mbështetjen e përpjekjeve të Republikës së Shqipërisë për zbutjen e pandemisë Covid-19, në shumën prej 60 milionë euro.

Marrëveshja ka si qëllim kryesor që, nëpërmjet instrumentit të mbështetjes buxhetore, të sigurojë fondet financiare të nevojshme për të financuar shpenzimet buxhetore për përballimin e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Kjo mbështetje buxhetore do të përdoret për mbrojtjen e shëndetit publik, parandalimin dhe reagimin ndaj rrezikut që paraqet Covid-19, si dhe fuqizimin e sistemeve kombëtare të gatishmërisë së shëndetit publik.

Mbështetja e sektorit shëndetësor për të reaguar ndaj Covid-19 menjëherë dhe në një periudhë afatmesme konsiston në fuqizimin e sistemit shëndetësor për rritjen e kapaciteteve për trajtimin e rasteve të Covid-19 dhe sëmundjeve që lidhen me të, si dhe në sigurimin e vaksinës së Covid-19 për mbrojtjen e popullatës nga rreziqet.

Vendet që kanë shfrytëzuar instrumentin e huas për mbështetjen e sektorit publik në përballimin e pandemisë janë 12, me një vlerë prej rreth 1,7 miliardë euro, si, për shembull,

Spanja 200 milionë, Italia 300 milionë, Greqia 200 milionë, ose vendet e rajonit, si Kosova 60 milionë dhe Serbia 200 milionë.

Kjo hua e akorduar vjen me terma tejet të butë, siç e thashë, është në shumën prej 60 milionë eurosh, me një afat maturimi 15 vjet dhe pritet me një interes më të butë se vetë kreditë e tjera të akorduara nga banka, në 0,5%.

Kjo marrëveshje është e parashikuar në ligjin për buxhetit për vitin 2021.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zëvendësministre!

Kolegu Bllako, fjala për ju, si relator.

**Alqi Bllako** – Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa rënë në përsëritje të asaj që relatoi zëvendësministrja Xhemali, ky është një projektligj i propozuar nga Këshilli i Ministrave, të cilin Komisioni për Politikën e Jashtme e shqyrton në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32 deri në 38 të Rregullores së Kuvendit.

Shkurtimisht, ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, për mbështetjen e përpjekjeve të Republikës së Shqipërisë për zbutjen e pandemisë Covid-19, në shumën prej 60 milionë euro.

Marrëveshja ka si qëllim kryesor që, nëpërmjet instrumentit të mbështetjes buxhetore, të sigurojë fondet financiare të nevojshme për të financuar shpenzimet buxhetore për përballimin e situatës së krijuar nga pandemia e Covid-19.

Objektivi kryesor i instrumentit të huas, që miratohet nëpërmjet këtij projektligji, është të ndihmojë vendin në përpjekjet për të siguruar pajisje, barna dhe shërbime mjekësore për ata të cilët janë prekur nga Covid-19.

Gjithashtu, nëpërmjet këtij projektligji mundësohet blerja e vaksinave kundër Covid-19 për vaksinimin e popullatës, marrja e stafit shtesë, nëse është e nevojshme, për përballimin e infeksioneve me Covid-19 apo pagesat e stafit jashtë orarit, në rastet kur nevojiten.

Kjo kredi ka një maturim të parashikuar maksimal prej 15 vjetësh, i cili zbritet në varësi të periudhës pa pagesë principali, që do të kërkohet nga pala shqiptare.

Interesi i përcaktuar për kredinë është mbi bazën e tregut në momentin e disbursimit.

Duke parë edhe rëndësinë për të cilën merret kjo hua dhe duke qenë se jemi ende në zhvillim të një pandemie globale, pa ditur se kur do të përfundojë dhe se nevojat buxhetore si

korrente, ashtu dhe të ardhshme, pa diskutim, do të jenë të shtuara, ftoj kolegët deputetë ta votojnë dhe ta mbështesin këtë marrëveshje.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit kolegut Bllako!

Kolegë deputetë, fjala është për ju, për pyetje ose komente.

Kush e do fjalën?

Fjala për kolegun Shpëtim Idrizi.

**Shpëtim Idrizi** – Në parim jam dakord që në kushtet e pandemisë sigurisht që ka nevojë të kemi financimet e duhura, por kam një pyetje për zëvendësministren: sa grante dhe kredi ka marrë qeveria shqiptare gjatë kësaj periudhe në mbështetje të pandemisë? Sepse dëgjojmë herë pas here për mbështetjen me grante dhe për marrjen e kredive.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit kolegut Idrizi!

Fjala për kolegun Kreshnik Çollaku.

**Kreshnik Çollaku** – Përshëndetje të gjithëve!

Në fakt, edhe unë, absolutisht, në parim e mbështes marrjen e grantit dhe huas, duke shpresuar që kjo të realizojë përballimin e kësaj situatës, por jo më shumë se ligjin e propozuar, për të cilin ne e shprehëm mbështetjen, do të doja ta shfrytëzoja këtë moment edhe për të nxjerrë një shqetësim, sepse, përveçse jemi pjesëtarë të komisionit, jemi dhe përfaqësues të njerëzve. Mendoj se përballimi i situatës së Covid-it ka kaluar dimensionin e një situatë klinike, pra po kthehet në një fenomen dhe në një ngjarje, në një plagë të rëndë edhe sociale.

Unë mendoj se pikërisht përpjekjet e strukturave shtetërore për trajtimin e këtij fenomeni nuk duhet të kufizohen vetëm në raportime shifrash, investimesh për vaksinat apo për pajisje spitalore. Është një fenomen, i cili po zgjerohet më tej.

Më lejoni që, shumë shkurtimisht, t'ju rrëfej një ngjarje të fundit të dhimbshme të para disa javëve. Një qytetar, Vojo Totozani, ka ndërruar jetë në një nga spitalet tona para disa javësh në një dhomë spitali. I biri mjek, Andi, pavarësisht të gjitha letrave dhe kërkesave ndaj ministrisë e drejtorisë, e ka pasur të pamundur të afrohet pranë të atit dhe të dëgjojë fjalën e fundit prej tij. E kuptoj që janë masat klinike që detyrojnë disa sjellje të tilla, por besoj se si ky rast ka dhjetëra e qindra të tjerë. Ne, ministria, por edhe të gjitha strukturat shtetërore në vend duhet të shikojmë në trajtimin edhe më të gjerë të përballimit të këtyre situatave. Nuk mund ta trajtojmë vetëm klinikisht përballimin e kësaj plage dhe të harrojmë një dimension human, pra nuk mund të shërojmë duke u dehumanizuar. Unë nuk jam mjek, nuk pretendoj të jap versionet e mia për zgjidhjen e këtyre problematikave, por do të ftoj ata

që janë përgjegjës për përballimin e këtyre situatave të kuptojnë dhe dimensionet njerëzore dhe, patjetër, të përshtaten procedurat, klinikat, masat edhe në përballimin e këtyre ngjarjeve, sepse, sinqerisht, jeta ka një vlerë, por edhe plagët që shkaktojnë këto procedura apo kjo mënyrë më pas nuk janë po aq të vogla.

Kështu që ftoj sinqerisht drejtuesit e Ministrisë së Shëndetësisë t'i rishikojnë procedurat, të rishikojnë edhe dimensionin njerëzor dhe të gjithë ne ta kuptojmë që kjo nuk përballohet vetëm duke marrë vaskina, të cilat, patjetër, duhen dhe jam në mbështetje të këtyre proceseve, por dhe duke rikonceptuar marrëdhëniet njerëzore në tërësi dhe marrëdhëniet me të lënduarit, me familjarët.

Më besoni, është një ndër shqetësimet madhore. Radhët e njerëzve pranë spitaleve, pamundësia për të takuar njerëzit që ndërrojnë jetë apo janë në ditët e fundit të jetës, është gjithashtu e rëndë.

Kështu që, pa pasur një formulë timen, ftoj ata që janë më ekspertë të këtyre fushave të kthejnë një sy dhe mbase t'i ripërshtasin procedurat dhe mënyrën edhe me këto situata.

Patjetër, e konfirmoj votën time për ta mbështetur projektligjin. Këto kisha. Sinqerisht, mendoj se janë po aq të dhimbshme plagët sociale sa janë edhe plaga e infektimit apo klinikat pandemike.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Kreshnik, faleminderit për sensibilitetin me të cilin e sjell këtë gjë!

Ne jemi të gjithë absolutisht të ndërgjegjshëm që kjo do të vazhdojë të jetë një plagë sociale dhe përtej gjithë respektimit të protokolleve, ndoshta na duhet të diskutojmë për një qasje. Besoj se askush nuk e ka formulën, nuk e kanë as njerëzit shumë më profesioniste se ne, sepse të gjithë kanë qenë të “surprizuar” nga vetë fakti që janë përballur me një gjë që ka qenë e panjohur dhe nga ditët që shkojnë gjithsekush mëson nga një leksion.

Të falënderoj për sensibilitetin me të cilën e sjell këtë gjë, edhe për mbështetjen në përgjithësi të projektligjit në parim, sepse ne e shikojmë që do të na duhet të përballemi gjatë me këtë situatë!

Zëvendësministre, fjala është për ju, për pyetjen e zotit Idrizi.

**Adela Xhemali** – Faleminderit!

Duke qenë se pandemia ka qenë një nga prioritetet e buxheteve të viteve 2020, 2021 dhe 2022, është siguruar që të gjithë shpenzimet të financohen, ndërkohë në paralel janë marrë grante, kredi të buta dhe/ose mbështetje buxhetore për financat publike, në mënyrë që të sigurohet financimi i këtyre shpenzimeve. Ndër to mund të përmend që gjatë vitit 2020 është kaluar kredia e Bankës Botërore për Covid-in, pra po përmend ato që ishin të emërtuara

nga institucionet financiare ndërkombëtare, instrumente të reja për emergjencën Covid, dhe Shqipëria ka marrë 15 milionë euro. Komisioni Europian ka dhënë menjëherë 4 milionë euro për pajisje të ndryshme dhe ka sjellë pajisjet në Shqipëri, më pas ka dhënë 11 milionë euro për vaksina; në një përpjekje të mëvonshme ka shtuar disa nga grantet në mbështetjet buxhetore sektoriale për pjesën sociale me 10 milionë euro të tjera. Kjo, gjithashtu, është një kredi, një mbështetje buxhetore që Këshilli i Europës ua ka dhënë si mundësi të gjitha vendeve anëtare për të mbështetur financat publike, që po financojnë shpenzime ekstra për pandeminë. Ne kemi marrë 60 milion euro.

Gjithashtu, kemi marrë edhe mbështetje të tjera buxhetore, por që kanë qenë për të plotësuar deficitin, në vijim të krizës dhe të rënies së të ardhurave që është shkaktuar nga mbyllja gjatë vitit 2020 në të gjithë botën.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Zëvendësministre, e gjykoj të drejtë kërkesën e kolegut Idrizi për t’u informuar më në detaje. Ndaj, në cilësinë e kryetares së komisionit dhe në emër të anëtarëve të këtij komisioni, do të kërkoja të sillnit pranë komisionit një informacion ku të jenë të listuara të gjitha huatë, grantet e marra, që janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë, pse jo dhe të tërthortë me pandeminë.

Kështu që, pa ju vënë në presion, besoj se do të ishte e mundur nga ana juaj dhe e nevojshme nga ana jonë që ta kemi këtë informacion për ditët në vazhdim. Besoj se edhe zoti Idrizi është dakord me kërkesën që sapo bëra.

Zoti Idrizi, ke nevojë të riflasësh?

Fjala për ju.

**Shpëtim Idrizi** – Doja t’i bashkohesha kësaj që sapo tha kryetarja. E kuptoj që koha juaj është e pamjaftueshme për të pasur një listim të të gjitha garanteve, kredive e huave që ne kemi marrë për përballimin e pandemisë, por besoj se do të ishte me interes, siç e theksoi dhe kryetarja, të kishim një listë të të gjitha granteve, kredive dhe huave që ka marrë Shqipëria si mbështetje për Covid-in. Akoma më shumë kjo bëhet imperative, sepse, me sa duket, ka nevojë që kjo mbështetje që kemi marrë bashkë me fondet buxhetore, të përputhet me një strategji të qartë se si do ta përballojmë pandeminë, e cila, me sa duket, është në zgjatje. Pra, ka të bëjë jo vetëm me masat, distancimin social, vaksinimin e të tjera, por edhe me kohëzgjatjen e kësaj pandemie, e cila herë-herë është e panjohur. Në këtë kuptim, doja të sillja sensibilitetin, sepse imagjioni, janë me dhjetëra e mijëra shqiptarë, që, për hir të së vërtetës, shpenzimet për kalimin e Covid-it i kanë pasur mbi 1000 euro. Pra, është një kosto shumë e madhe edhe për qytetarët dhe familjet shqiptare. Prandaj e theksova që në parim jam

plotësisht dakord, por kemi nevojë për një dijeni më të mirë, për një njohuri më të mirë të përputhjes të të gjitha granteve, kredive dhe huave që marrim me një strategji për përballimin e pandemisë, edhe si janë shpenzuar ato deri më sot, por edhe se si kjo ndihmë financiare që ne marrim përputhet me një strategji të përballimit të Covid-it.

Faleminderit, kryetare, edhe për kërkesën!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit juve, që sillni këto shqetësime dhe sensibilizoni në diskutimet tona një çështje që është pranë gjithsecilit prej nesh dhe, sigurisht, na afekton në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë! Kështu që e vlerësoj ndërhyrjen tuaj, po ashtu dhe të zotit Çollaku.

A ka pyetje dhe diskutime të tjera? Nuk ka.

Atëherë, më lejoni ta hedh në votim projektligjin.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Jeni të gjithë në kamera dhe shikoj që jeni dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Neni 1.

Miratohet me 1 abstenim.

Neni 2.

Ju faleminderit!

Kalojmë në votim në tërësi të projektligjit. Të gjithë janë dakord. Ka vetëm 1 abstenim.

Miratohet.

Ju falënderoj shumë për prezencën dhe për kohën!

Shihemi së shpejti!

Punë të mbarë!

**MBYLLET MBLEDHJA**